

# community

The New Apostolic Church around the world

02/2021/AI



## Shpresë për rikthimin e Jezusit

*Kryeartikulli*  
Stabiliteti shpirtëror

*Shërbesa fetare*  
Krishti – e ardhmja jonë

*Doktrina e kishës*  
Fundi i jetës njerëzore

New Apostolic Church  
International



## ■ Kryeartikulli

3 Stabiliteti shpirtëror

## ■ Shërbesa fetare

4 Krishti – e ardhmja jonë

## ■ Këndi i fëmijëve

10 Shndërrimi i Saulit

12 Për vizitë te Deyvid në Exú  
(Brazil)

## ■ Doktrina

14 Fundi i jetës njerëzore

## ■ Lajme globale

18 Ndryshime në rrethin e  
apostujve (2/2020)

# Stabiliteti shpirtëror

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

në artikullin e dytë të besimit tonë ne pohojmë besimin tonë ndaj Birit të Perëndisë:

„Unë besoj në Jezun Krisht, në birin e lindur prej zotit, në Perëndinë tonë, i cili është ngjizur prej Shpirtit të Shenjtë, është lindur prej virgjëreshës Maria dhe që ka vuajtur prej Ponc Pilatit, që është kryqëzuar, që ka vdekur, është varrosur, që ka shkuar në mbretërinë e të vdekurve dhe që në ditën e tretë është ringjallur prej vdekjes dhe është ngjitur në Qiell; që ka zënë vend në të djathtë të Perëndisë, Atit të gjithfuqishëm dhe prej të cilit do të vijë përsëri.“

Ky rrëfim apo pohim na shoqëron gjatë gjithë jetës sonë; është përmbajtja e shërbesave tona fetare dhe bisedave tona. Por është gjithashtu një shprehje e marrëdhënies sonë me Zotin dhe e sigurisë dhe shpresës sonë të gjallë. Nga kjo fitohen tre shtylla të besimit tonë. Ato na japin stabilitet shpirtëror për tërë vitin:

- Jezusi na do! Ai e ka treguar dashurinë e tij: Ai vdiq për ty dhe për mua.
- Jezusi është më i forti! Ai ka gjithë pushtetin. Ai doli fitimtar mbi mëkat, vdekjen dhe ferrin.
- Jezusi do të vijë përsëri! Ai do të vijë së shpejti – për shpëtimin tonë, për çlirimin tonë.

Të dashur motra e vëllezër, këto tre shtylla na japin orientim dhe stabilitet në jetën tonë – edhe kur lëkundemi pak, pasi ndonjëherë era është shumë e fortë.



Foto: NAK Internacional

Edhe për vitin 2021 qëndrojmë të vendosur: Ne orientohe mi prej Jezun Krishtit. Ne i nënshtrohemi vullnetit të Perëndisë. Le të testojmë gjithnjë e vazhdimisht, nëse gjithshka në jetën tonë përshtatet me Jezun Krishtin. Dhe nëse jo, le të ndërmarrim masat dhe korigjimet e nevojshme, e të domosdoshme.

Zoti do të vijë së shpejti! Ky është besimi ynë, siguria jonë dhe gëzimi ynë i madh.

Të fala të përzemërta

Juaji Jean-Luc Schneider

# I Krishti – e ardhmja jonë



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider mbajti më 3 Janar 2021 në bashkësinë e Winterthur-it (Zvicër) shërbesën fetare të fillimvitit.

Fotot: NAK Zvicër

Të dashurit e mi, motra e vëllezër, në fillim dua të falenderoj në emër të motrave dhe vëllezërve të Gjermanisë Veriore dhe Lindore bashkësinë në Winterthur, e cila na pranoi sot në mëngjes dhe unë prej këtu ta mbaj këtë shërbesë fetare për motrat e vëllezërit e Gjermanisë Veriore dhe Lindore.

Unë nuk e di se kush e zgjodhi këngën e hyrjes, e fillimit të shërbesës, por thjesht them faleminderit edhe për këtë. Me rregullat dhe masat e tanishme për mua që e zorshme të mos këndoj dot me zë të lartë por vetëm të përshpëris. Idea është shumë e bukur që Perëndia do të ndërtojë veprën e tij: „Shkëlqyeshëm, shkëlqyeshëm e ndërton Zoti veprën e vet“. Ky duhet të jetë edhe programi në këtë vit të ri. Pas këtij viti që kemi përpara fshihen shumë pikpyetje. Askush nuk e di me saktësi, veçse një gjë qëndron: Perëndia ka programin e tij dhe e vazhdon atë më tej. Edhe për vitin 2021 do ta vazhdojë ai planin e tij. Unë e thashë këtë në lidhje me vitin që kaloi, por e përsëris me ndërgjegje edhe

Hebr 12,1b.2a

*„Le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh, duke i drejtuar sytë te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit“*

për këtë vit: 2021 është vetëm një pjesë kohore e planit të tij të shpëtimit. Ky plan ka filluar që mbas rënies në mëkat dhe do të përfundojë në Krijimin e ri, kur të çliruaret do të jenë pranë Zotit dhe njerëzit dhe Krijimi do të jenë, ashtu siç do Zoti. Atëhere do të ketë Paqe, Gëzim, Brohori e Hare, sepse gjithçka përsëri i përgjigjet vullnetit të Zotit. Ky është edhe qëllimi i planit të Zotit për shpëtimin.

Ngjarja tjetër në planin e Zotit për shpëtimin është edhe rikthimi i Jezusit. Ne besojmë fort, se Jezu Krishti do të kthehet përsëri dhe do të marrë drejt vetes bashkësinë e tij nuse. Ai do ta drejtojë atë në kohë për në mbretërinë e tij, ku çdo gjë do të jetë siç do Zoti. Pastaj do të jemi edhe ne në lavdinë e Perëndisë. Kjo është e ardhmja jonë. Ne kemi vendosur për këtë gjë: ne dëshërojmë të marrim pjesë në rikthimin e Jezusit prandaj dhe për këtë vit motoja jonë është: „Krishti – e ardhmja jonë“. Ne besojmë në rikthimin e Jezusit dhe dëshërojmë të përgatitemi për këtë ditë.

Madje edhe në rrethin e të krishterëve na drejtojnë pyetjen, nëse me të vërtetë guxojmë edhe në kohën e sotme të predikojmë, se Jezu Krishti do të kthehet përsëri. PO! Kjo bën pjesë në detyrën tonë. Për këtë janë dërguar apostujt. Si lajmëtarë të Jezusit nuk mund të bëjnë gjë tjetër veçse të shpallin rikthimin e Krishtit. Ky është një premtim i Zotit, prandaj është dhe do të mbesë i vërtetë! Pavarësisht se sa njerëz e besojnë këtë. Vërtetësia e premtimeve të Perëndisë nuk varet nga ky fakt. Kujtoni përmbajtjen e madhe! Kujtoni lindjen e Mesisë! Kujtoni ringjalljen e Jezusit! Sa njerëz besuan në to? Një grusht. Por kjo gjë nuk e shqetësoi Zotin. Ai kishte premtuar dhe e realizoi atë. Kjo vlen edhe për rikthimin e Jezusit. Krishti është e ardhmja jonë. Ai do të vijë dhe ne përgatitemi për këtë. Nuk kemi asnjë pike dyshimi, ne besojmë në fjalën e tij.

Shumë njerëz thonë se kjo është vetëm një histori, të cilën kisha ua tregon besimtarëve të saj, për t'i ngushëlluar ata, për t'ua bërë më të durueshmë të sotmen: „Ah, mos u shqetësoni, çdo gjë do të shkojë mirë! Nesër akoma më mirë. Qëndroni me ne dhe do ta shikoni“. Sigurisht që ne nuk ëndërrojmë me sy hapur, nuk kërkojmë mbrojtje në endrra kur nuk na pëlqen realiteti i sotëm. Motra e vëllezër, një i krishterë apostolik i ri nuk është fanatik, nuk është ëndërrimtar. Ne jemi gra dhe burra të veprimit. Ne nuk ëndërrojmë, përkundrazi kemi një qëllim: Rikthimin e Jezusit. Për këtë përgatisim veten. Ne kemi një plan veprimi dhe ai do të vazhdojë edhe në vitin 2021.

Të përgatitesh për ardhjen e Jezusit Krishtit do të thotë të duash të bëhesh ashtu siç Zoti dëshiron të jemi. Shëmbulli ynë për këtë është vetë Jezu Krishti. Ai që njeriu që zbatoi pikë për pikë vullnetin e Perëndisë. Me qenë se ne duam të hyjmë në mbretërinë e tij, ne duhet të bëhemi ashtu siç do Zoti, prandaj dhe orientohemi nga njeriu, i cili zbatoi me përpikmëri vullnetin e Perëndisë: nga Jezu Krishti. Ky është edhe plani ynë i veprimit. Edhe për të vlen: „Krishti – e ardhmja jonë“. Ne dëshërojmë të bëhemi si ai, me qëllim që të mund të jemi atje ku është ai.

Kjo përgatitje përshkruhet në Bibël me një tablo shumë të bukur dhe është tematizuar shumë here nën këndvështrime të shumta: tabloja e një gare, e një vrapimi. I krishteri hyn, merr pjesë në një garë vrapimi. Me anë të kësaj Fryma e Perëndisë do të tregojë që përgatitja për ardhjen e Jezusit Krishtit nuk është shetitje. Nuk është garë e thjeshtë, e rehatshme. Është garë e fortë. Kjo do të thotë se kushton përpjekje, forcë. Duhet të tregosh zell dhe të harxhosh energji. Nuk mjafton vetëm të regjistrohesh e të marrësh pjesë. Jo, duhet të përpiqesh për të qenë apo për t'u bërë ashtu siç do Zoti. Të kushton punë, përpjekje për t'iu përshtatur vullnetit të Zotit.

Kështu do të jetë edhe këtë vit. Prandaj duhet të punojmë vazhdimisht. Sot nuk pranohet kjo edhe kaq lehtë. Sot kërkohet çdo gjë sa më lehtë, më rehat. Porse pritja për rikthimin e Jezusit Krishtit nuk është e rehatshme. Ajo është një luftë, një garë.

Në garë ka edhe mundësi për të dështuar. Pasi një garë nuk e fitojnë dot të gjithë, por vetëm një. Për të fituar, për të arritur të marrësh kurorën e jetës së përjetshme ka vetëm një rrugë, duhet të vraposh deri në fund të garës. Edhe një herë: Nuk mjefton vetëm të regjistrohesh e të marrësh pjesë. Duhet të punosh dhe veprësh deri në fund të garës. Çfarë do që të ndodhë. Kush ndalon më përpara humbet. Më qartë se me këtë tablo nuk mund ta shprehësh. Është garë. Kush nuk duron deri në fund, humbet.

Në letërën e dytë të Palit drejtuar Timoteut thuhet, se një garë mund të fitohet, kur lufton sipas rregullave të saj (krhs 2. Timoteu 2,5). Kjo është e qartë: Kur zhvillohen lojrat olimprike, në një garë mund të fitojë vetëm ai, i cili i përmbahet rregullave të garës. Këto rregulla nuk i vendosim dot ne. ato i vendos Perëndia. Ato i vendos Jezu Krishti. Një nga rregullat e kësaj gare është: „Duhet të orientohesh nga mësimet e apostujve. Ata shpallin Ungjillin“. Një tjetër thotë: „Ti mund të jesh i lumtur vetëm në bashkësinë e

*Jezusi nuk gaboi kur të  
thirri, kur të zgjodhi  
ty. Ai e dinte se ti  
mund ta arrish këtë.*

besimtarëve. Një i vetëm nuk mund ta arrijë kurrë qëllimin“. Po e le vetëm te këto dy rregulla. Po nuk u respektuan këto të dyja, nuk mund ta fitosh dot garën.

„Krishti – e ardhmja jonë “: Me një siguri absolute Ai do të vijë përsëri. Që të jemi të përgatitur për këtë, duhet të bëhemi si Ai. Kjo është një garë që kërkon energji të shumta. Ne duhet të durojmë, të punojmë deri në fund dhe të zbatojmë rregullat e garës.

Shkronjësi i letrës drejtuar hebrenjve thotë: „ Le të rendim me durim në udhën, në garën që është përpara nesh “ – me durim, do me thënë me këmbëngulje – „ duke i drejtuar sytë te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit “. Krishti është e ardhmja jonë. Ai është edhe ai që do të na ndihmojë për ta arritur këtë; pa të nuk mund të arrijmë asgjë. Dhe këtu thotë që duhet të orientohemi nga Jezusi me qëllim që të marrim forcë, fuqi për të fituar. Edhe kjo është diçka e rëndësishme për këtë vit: Le të orientohemi gjithnjë nga Jezu Krishti, pasi ai është fillimi dhe kompletimi i besimit tonë. Ai na zgjodhi. Unë nuk e vendos dot vetë se dua të shkoj në qiell. Ai qe i pari. Ai më ftoi ty dhe mua dhe na dha mundësinë për të qenë në përjetësi me të. E bëri këtë me ndërgjegje. Ai na njihete shumë më parë, para se të lindnim e dinte se cilët jemi, çfarë mund të bëjmë e çfarë jo. Ai vendosi që ne mundemi dhe do ta arrijmë qëllimin. Le të orientohemi nga kreu i besimit tonë. Ai nuk gaboi kur të thirri. Ai e dinte se do të mundje, nëse do të doje. Ai sakrifikoi, dha jetën e tij, që ti të gjeje çlirim. Ai të jep ty vazhdimisht forcën që të duhet. Motra e vëllezër, le të drejtohem nga Jezusi! Tek ai gjejmë forcën dhe energjinë që na duhet për ta përballuar e përfunduar garën.

Kjo fuqi është një forcë e mrekullueshme, është një forcë tërheqëse. Ajo na shtyn për të vrapuar më tej. Ajo forcë tërheqëse e dashurisë së tij na ndihmon në këtë garë. Vështroni drejt tij! Kujtoni dashurinë e tij! Kujtoni sakrificën e tij! Kujtoni përsosmërinë e tij! Kujtoni natyrën, qenien e tij! Kujtoni lavdinë e tij! Nëse do të merremi në mënyrë intensive me natyrën, qenien e Jezu Krishtit, ajo do të na motivojë për të ecur përpara – edhe nëse ndonjëherë do të jetë e vështirë, edhe nëse do të jetë shumë keq. Kur unë kujtoj Jezu Krishtin, kur kërkoj të bashkohem me të, atëhere nuk do të kem shkak të dorëzohem. Do të kem arsye për të ecur gjithnjë përpara, pasi dua të jem si ai dhe dua të jem pranë tij përgjithmonë. Kjo është zgjidhja; kjo është gjëja më e madhe; ky është motivacioni ynë; kjo është forca jonë. Le të orientohemi gjithnjë drejt Jezu Krishtit.

Të shohësh lart do të thotë gjithashtu të mos përqëndrohesh patjetër tek mjedisi që të rrethon: te vështirësitë, te të tjerët, te gjithshka që ndodh rrotull nesh. Kujtoni Pjetrin, ndërsa po ecte mbi ujë: përse kohë mbante sytë drejtuar te Jezusi,



Bishop Rudolf Fässler (Zvicër)

arriti të ecte. Ndërsa kur hodhi syte te dallgët e te stuhia, humbi kurajën dhe filloi të zhytej. Kjo është këshilla ime për vitin 2021: Le t'i drejtojmë sytë drejt Jezu Krishtit! Jo te vështirësitë, jo te njerëzit e tjerë – çfarë thonë, çfarë mendojnë, çfarë bëjnë. Le të drejtohem me vetëdije drejt Jezu Krishtit. Ai na jep forcë për të ecur më tej.

Le të drejtohem me vetëdije drejt Jezu Krishtit dhe jo drejt asaj që ne arrijmë. Ai është kompletuesi i besimit tonë. Nëse ne mendojmë vetëm se çfarë arrijmë, çfarë fitojmë e sakrifikojmë, atëhere nuk do të arrijmë dot asgjë.

Akoma dhe më pak do të arrijmë nëse do ta lemë veten të dekurajohemi nga problemet tona, nga dobësitë dhe jopërsosmëria jonë. Ai është kreu, fillimi i besimit tonë. Ai është kompletimi, mbarimi i besimit tonë. Nëse do të hyjmë në mbretërinë e tij, ajo do të ndodhë falë mëshirës së tij. Kjo na bën të përulur, por nga ana tjetër na jep edhe shpresë e optimizëm. Pjesëmarrja jonë në ditën e Zotit nuk varet nga mendimi i tjetrit, nuk varet nga arritjet tona, porse është vetëm mëshirë. Le të kujdesemi me vetëdije për të pasë mëshirën e tij. Ai është kompletuesi i besimit tonë. Le të orientohemi gjithnjë nga Jezu Krishti dhe jo nga vështirësitë ose nga arritjet tona.

Ne nuk duhet të shikojmë fort edhe nevojat tona. Kjo është shpesh një tendencë ndër njerëzit. Njeriu merret shumë me vetveten. Më vonë pendohet dhe i vjen keq për vetveten.



Gjithshka është keq dhe e padrejtë. Nuk e kisha merituar këtë: „Përse unë, gjithnjë unë e vetëm unë?“ Më parë ka qenë më mirë, sot është bërë kaq vështirë etj., etj..

Ky rënkim, kjo vet-keqardhje – motra e vëllezër, po jua them shumë qartë – është vetëm një harxhim kohe dhe energjie. Le të orientohe mi prej Jezu Krishtit! Ai na thërret, na thotë: „Eja, ti mundesh!“

Le të veprojmë dashuria e tij si forcë tërheqëse për ne! Ne e duam dashurinë e tij, mëshirën e tij dhe i besojmë gjithpushtetshmërisë së tij. Ai do ta përfundojë veprën e tij. Ai është e ardhmja jonë. Ai na jep garancinë, që ne mund ta arrijmë këtë, nëse e ndjekim pas atë.

Krishti është garancia e së ardhmes sonë.

Ne jemi njerëzit e së ardhmes. Por kjo zgjedhje – Jezu Krishti –, që ne kemi bërë për të ardhmen, formon e zbukuron edhe të sotmen tonë. Nëse ne përgatitemi në mënyrë aktive për të qenë si Ai, ashtu siç na do Zoti, ka efekt edhe në jetën tonë. Edhe për këtë nuk jemi ëndërrimtarë, porse duam konkretisht edhe në jetën tonë të përditëhme të orientohe mi drejt Jezu Krishtit. Ne duam sot të zbatojmë vullnetin e tij dhe të veprojmë sipas shembullit të tij – edhe

në kohë të vështira. Vitin që shkoi pati kriza të shumta. Këtu në Europë bëhet fjalë për Koronën, diku tjetër në botë kanë edhe probleme të tjera veç asaj, të cilat janë po kaq të këqija. Njerëzit reagojnë në mënyra të ndryshme. Të krishterët p.sh.: Ka të krishterë që veprojnë në mënyrë shembëllore. Mund të raportojmë gjëra me të vërtetë të bukura. Aty-këtu shikojmë edhe të kundërtën. Nuk thonë kot se në situatë

krize kupton se si janë njerëzit, çfarë i shtyn, çfarë ndodh brenda tyre. Diçka më shqetëson – jo vetëm në kishën tonë, porse te të gjithë të krishterët në përgjithësi, tek ata që thonë se janë me të vërtetë të krishterë: Aty-këtu konstaton që në situatë krize bëhet

shumë më e madhe fjala „unë“; problemet e mia, mendimi im, mirëqenia ime dhe interesat e mia. Tek dikush kjo „unë“ zmadhohet kaq shumë, sa që Jezusi shkruhet me të vogël. Ajo „unë“ bëhet kaq e madhe, sa që „ne“ harrohet fare. Ajo vepron në mënyra e forma të ndryshme dhe më bën të mendoj thellë.

Të dashur motra e vëllezër, ne dëshërojmë të përgatitemi për Jezu Krishtin, për rikthimin e tij. Edhe sot ne orientohe mi nga shembulli i Zotit dhe mjeshtrit tonë Jezu Krisht, në çdo

*Në bashkësi – edhe pse  
jemi kaq të ndryshëm – ne  
kemi të njëjtin qëllim.  
Dhe kjo përbën unitetin.*



Apostuli kryesor Schneider ndan Darkën e Shenjtë edhe për shpirtat e larguar nga kjo jetë.

lloj situatë, sidoqoftë ajo. Shembulli ynë Jezu Krisht është përshkruar shumë thjesht: Ai ishte vetë dashuria. Ai falte; ai ndihmonte; ai ndante; ai shërbente – „Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbejnë atij, porse që ai të shërbejë“ (Marku 10,45); ai sakrifikoi veten për tjetrin dhe e ndante dhimbjen me tjetrin. Ai është shembull për ne edhe në ditë të vështira.

Dje lexova diçka në bibël, që më mbeti në mendje. Jezusi u pyet nëse duhet të paguheshin taksat mbretit. Jezusi iu përgjigj: „Jepini pra mbretit atë që i takon atij, dhe Zotit atë që i takon Zotit“ (Mateu 22,21). Ju e dini psenë. Ata donin ta gjenin Jezusin të papërgatitur. Përgjigjja e tij nuk u pëlqeu aspak atyre. Ata shpresuan se do t'u thoshte që të mos i jepnin mbretit asnjë taksë. Kjo do t'u kishte pëlqyer. Jezu Krishti me këtë donte të thoshte ndër të tjera, që ne, siç thuhet edhe te Katekizmi, „duhet të kemi një marrëdhënie pozitive dhe të jemi të bindur ndaj shtetit, autoritetit të kësaj bote“ (KNK 2.4. 10). Ne, si apostolikë të rinj e pohojmë këtë edhe tek artikulli i dhjetë i besimit tonë. Kornizën e krijojnë urdhëresat e Zotit. Përsa kohë që rregullat dhe ligjet e autoriteteve të larta, të administratës shtetërore nuk bien ndesh me vullnetin e Perëndisë, ne do të jemi të përlurur përpara tyre.

Ka njerëz që më kanë pyetur se përse mbaj edhe unë maskë. Atyre ju përgjigjem: „Pasi jam apostolik i ri.“ ky është një rregull, një masë e administratës shtetërore. Referenca nëse do t'i bindem apo jo këtij rregulli është urdhërimi i Zotit -

jo mendimi im personal, as pikëpamja ime personale. Unë ju rekomandoj të lexoni te Katekizmi kapitullin përkatës. Ne orientohemi sipas rregullave dhe masave të qeverisë përkatëse, nëse ato nuk bien ndesh me ligjet e Zotit. Ky nuk është mendimi im, porse ligji, urdhëresa e Zotit.

Në kohën e sotme ne orientohemi sipas shembullit të Jezu Krishtit. Edhe një herë: Ne nuk jemi fanatikë, ne nuk jemi ëndërrimtarë dhe deri sa Zoti të vijë ne do të mbetemi gra e burra të veprimit dhe planifikojmë të ardhmen tonë këtu në tokë. Unë nuk e di nëse Zoti do të vijë nesër apo në dhjetë a njëzet vjetë më vonë. Ne punojmë deri sa ai të vijë, pra, planifikojmë të ardhmen tonë këtu në tokë. Edhe në këto plane ne bazohemi tek Jezusi dhe i ndërtojmë ato mbi themelin e mësimave të tij, mbi Ungjillin. Në punë, në familje, në edukimin e fëmijëve e kudo ne i qëndrojmë besnikë mësimave të tij. Ne zbatojmë vullnetin e tij. Kjo vlen edhe në marrëdhëniet tona kundrejt gjërave tokësore, materiale; këtu mbahemi fort pas urdhëresës së Krishtit. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet tona kundrejt të tjerëve; ne i përmbahemi rregullave të Ungjillit. Edhe këtu përfshihet motoja. „Krishti – e ardhmja jonë“. Kjo është zgjedhja që ne kemi bërë dhe për këtë përgatitemi në mënyrë aktive. Kjo na kushton përpjekje të mëdha, e megjithatë ne durojmë me këmbëngulje deri në fund. Forcën për ta përballuar këtë e gjejmë te Jezu Krishti. Ne orientohemi vetëm nga ai. Ai është kreu dhe plotësuesi i besimit tonë. Ai është shembulli ynë, motivacioni ynë. Prej tij orientohemi. Kjo gjë ka efekt



edhe në të tashmen por edhe në planet që ne thurim për të ardhmen këtu në tokë.

Dua të përmend edhe një pikë të fundit përsa i përket motivacionit që unë zgjedha për këtë vit dhe që apostujt e distrikteve e aprovuan, e miratuan: „Krishti – e ardhmja jonë“. Nuk thamë: „Krishti – e ardhmja IME“, porse „Krishti – e ardhmja JONE“. Pra këtu vlejnjë rregullat hyjnore të Zotit. Njeriu mund të lumturohet me të vërtetë vetëm në bashkësinë e besimtarëve. Persona të veçantë nuk mund ta fitojnë garën. Brenda për brenda një bashkësie ne jemi me të vërtetë shumë të ndryshëm në çdo aspekt. Në mendime, situata, rrethana të jetës – gjithshka është e ndryshme. Pavarësisht nga kjo duam me ndërgjegje që edhe këtë vit të përqendrohemi, pasi kemi të njëjtin qëllim dhe na duhet të ecim në të njëjtën rrugë për ta arritur atë. Nuk dua ta thelloj më këtë gjë, pasi për këtë kemi të gjithë vitin përpara. Por s'duhet harruar që kjo është më e rëndësishmja. Le të përqendrohemi tek gjëja më kryesore: Në bashkësi – sado të ndryshëm që mund të jemi – ne kemi të njëjtin qëllim dhe na duhet të ecim të gjithë në të njëjtën rrugë, për ta arritur këtë. Kjo na bën të jemi një, në unitet.

Edhe një pikë tjetër që e kam shumë për zemër: „Krishti – e ardhmja jonë“. Kjo është e ardhmja ime, por edhe e fëmijëve të mi. Ne kujdesemi për ta. Unë imagjinoj prindër të rinj, të cilët kanë fëmijë të vegjel dhe pyesin veten: „Cfarë do të ndodhë me fëmijët tanë? Cila është e ardhmja e tyre? Si mund të ecet kështu?“ Motra e vëllezër, Krishti është edhe e ardhmja e tyre, e ardhmja e brezit të ri, e të rinjve dhe fëmijëve tanë. Edhe kur gjendja apo rrethanat janë krejtësisht ndryshe në çdo aspekt, një gjë mbetet: Krishti është edhe e ardhmja e tyre! Krishti është rruga, udha e cila i drejton ata drejt së ardhmes. Krishti është për ta zgjidhja më e mirë. Mësimet e tij, Ungjilli i tij. Ai është edhe kreu e plotësuesi i besimit të tyre. Edhe për ne vlen të themi: Krishti është e ardhmja e tyre!

Por kjo mund të realizohet kur vemë re, se Krishti është e ardhmja jonë. Ne nuk mund të presim nga fëmijët që ta besojnë këtë, që Krishti është e ardhmja e tyre, kur ata nuk e ndjejnë apo nuk e përjetojnë në fillim që Krishti është e ardhmja e prindërve të tyre. Që të mund ta kuptojnë që Krishti është e ardhmja e tyre, ata duhet ta njohin Krishtin, – të kaluarën dhe të sotmen, prezencën e tij. Që të mund ta kuptojnë që Krishti është e ardhmja e tyre, ata duhet ta njohin Krishtin si njeri; veprimin e tij, qenien apo natyrën e tij, ndërsa jetoi në këtë tokë. Këtë gjë ata nuk mund ta shohin në asnjë lloj ekrani. Këtë nuk e dëgjojnë në Mediat sociale. Këtë ata duhet ta dëgjojnë vetëm nga prindërit e tyre. Për këtë arsye po ju bëj një thirrje prindërve: Ju nuk keni nevojë t'u predikoni fëmijëve tuaj – edhe unë nuk e

kam bërë kurrë, pasi nuk ke asnjë shans –, por tregojni atyre here pas here për Jezusin: „Ah e di çfarë, më kujtohet një histori për këtë gjë. Jezusi ka bërë këtë apo atë në këtë rast.“ Krejtësisht spontanisht, krejtësisht në mënyrë normale, me qëllim që edhe ata ta ndjejnë që nuk është thjesht vetëm një histori, porse babai apo nëna besojnë, se Jezusi ka ekzistuar dhe se si ai ka punuar. Pra krejtësisht thjesht: „Ah po, Zoti Jezus ka bërë këtë apo atë, ai ka thënë këtë, ai ka vepruar apo reaguuar kështu“. Kjo nuk është detyra e mësueses së shkollës të së dielës, kjo është detyrë e prindërve! Le t'u tregojmë fëmijëve prezencën e Jezu Krishtit sot dhe le t'u themi: „Ah, a e di se duke e parë nga këndvështrimi i Jezusit, duhet ta vlerësojmë kështu. Po të kishte qenë ai këtu, do të kishte thënë“. Edhe një herë: kjo është detyra e prindërve, jo e shoqërisë, jo e kishës, jo e mësuesit, porse e prindërve.

Kjo është një fjalë ngushëlluese: Krishti është e ardhmja e fëmijëve tanë. Si një apel që me të vërtetë është kështu, ata duhet ta ndjejnë e përjetojnë, se Krishti është e ardhmja jonë. Pastaj mund t'ua transmetojmë edhe atyre.

Krishti – e ardhmja jonë“ – kjo vlen për bashkësinë, kjo vlen për fëmijët tanë, kjo vlen edhe për të gjithë njerëzit e tjerë. Ne e dime, që Krishti punon që të gjithë njerëzit të kenë mundësinë të gjejnë çlirim. Ky është edhe qëllimi i planit të tij të shpëtimit. Kjo duhet të influencojë edhe jetën tonë si dhe marrëdhëniet tona kundrejt njerëzve të tjerë. Të mos e harrojmë kurrë: Zoti Jezusi dëshiron të fitojë edhe atë njeri sado i keq apo i lig të jetë ai. Mbetet detyra jonë për t'ua bërë të mundur edhe të tjerëve, me qëllim që edhe ata të përjetojnë dashurinë e Perëndisë. Ata duhet ta dinë që Zoti i do, dhe se ai mund ta përjetojë këtë vetëm nëpërmjet Krishtit. Krishti është gjithashtu edhe e ardhmja e tjetrit, e të afërmit tonë.

## MENDIME KYCE

### E ardhmja jonë është te Krishti.

- Qëllimi ynë është, të jemi pranë Krishtit.
- Për ta arritur këtë, ne marrim forcë dhe motivacion prej Krishtit.
- E ardhmja që kemi zgjedhur, përcakton jetën tonë të përditëshme.

## TJETËRSIMI I SAULIT

SIPAS VEP. TË APOST. 9,1-19

*Sauli përndjek dhe kërcënon dishepujt e Jezusit, shumë prej tyre ka arritur edhe t'i kapë. Një ditë ai shkoi para një kryepriosti dhe i kërkoi (leje) fuqi e pushtet për të shkuar në sinagogën e Damaskut e për të arrestuar, pasuesit apo ndjekësit e doktrinës së re dhe për t'i sjellë ata në Jeruzalem.*



Sauli niset për atje. Kur arrin pranë Damaskut, i vret sytë papritur një dritë e forte, që zbriti nga qielli. Ai bie poshtë dhe dëgjon një zë, i cili i thotë: „Saul, Saul, përse më përndjek?“

Sauli pyet: „Kush je, Zot?“

„Unë jam Jezusi, që ti e përndjek. Çohu dhe hyr në qytet dhe do të të thuhet ç'duhet të bësh.“

Dhe njerëzit që udhëtonin me të ndaluan të habitur, sepse dëgjonin tingullin e zërit, por nuk shikonin njeri.

Sauli u çua. Por kur i çeli sytë, nuk shikonte dot më asgjë; ai u verbua.

Shoqëruesit e tij e morën përdore dhe e çuan në Damask. Tre ditë Sauli nuk shikonte asgjë, as nuk hante e as nuk pinte.

Në Damask jetonte një dishepull. Ai quhej Anania. Atëhere Jezusi i shfaqet në vegim dhe i thotë: „Anania!“ Anania i përgjigjet: „Ja ku jam, Zot.“

Dhe Jezusi i tha: „Cohu dhe shko në rrugën e quajtur e Drejtë dhe kërkoni në shtëpinë e Judës një njeri nga Tarsi me

emrin Saul. Këtë Saul do ta gjesh duke u lutur. Perëndia i ka treguar atij që ti, Anania, do hysh tek ai dhe duke i shtrirë duart mbi kokën e tij, do t'i kthesh dritën e syve.“ Anania u përgjigj: „O Zot, nga shumë veta kam dëgjuar për këtë njeri se sa të këqija u ka bërë shenjtorëve të tu në Jeruzalem. Edhe për Damaskun ka këtu një autorizim nga kryepriifti për të burgosur të gjithë ata, që thërrasin emrin tënd.“ Por Jezusi i tha: „Shko, sepse ai është vegla që unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim përpara johebrenjve, mbretërve dhe bijve

të Izraelit. Sepse unë do t'i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë për emrin tim.“

Atëhere Anania shkoi dhe hyri në atë shtëpi, dhe duke ia vënë duart mbi kokë i tha: „I dashur vëlla Saul, Jezusi, që të është shfaqur në rrugën nëpër të cilën ti po vije, më ka dërguar që të kesh përsëri dritën e syve dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë.“

Në këtë moment Sauli shikoi përsëri. Pastaj u ngrit dhe u pagëzua. Ai hëngri e piu dhe u forcua. Disa ditë më vonë ai fillon t'u flasë të gjithë njerëzve për Jezusin.



## TEK DEYVID NË EXÚ (BRAZIL)



Hallo, unë jam Deyvid.

Kjo është kisha jonë në Exú, unë e shoh atë që nga shtëpia ime. Në këtë kishë unë jam pagëzuar dhe kam marrë Vulën e Shenjtë.



Mamaja dhe kushërira ime janë mësueset e shkollës të së dielës. Në këtë ditë kur është bërë fotografia ka dhënë mësim mamaja ime. Jemi shumë pak fëmijë në bashkësi: kushërinjtë e mij Fladson dhe Israel si dhe unë.

Kur dikush ka ditëlindjen jashtë bashkësisë sonë, ne shkojmë të gjithë sëbashku për ta uruar. Ne përqipemi që ta duam njëri-tjetrin dhe ta jetojmë besimin tonë të bashkuar me Zotin.



Kjo është familja ime: Babai im Francisco është kryeplak dhe është drejtuesi i bashkësisë sonë. Përveç tij shikoni edhe nënën time Valdete, vëllanë tim Marcus dhe mua.

Shkollën nuk e kam shumë larg nga shtëpia ime, unë jam në klasën e tretë. Nëna më çon çdo ditë deri atje. Mbrapa është mësuesja ime Aparecida. Mua më pëlqen të qëndroj para, pasi mbrapa bëhet disi zhurmë. Këtë ditë unë i kisha dhënë mësueses sime një revistë të kishës sonë.



Ne jemi 28 nxënës në klasë; Ja ku i shikoni edhe shokët e shoqet e klasës. Dy mungojnë ...

Ushqimi im më i preferuar është Kuskus, një gjellë që vjen nga Verilindja e Brazilit, e cila përgatitet nga zierja e misrit. Më pëlqen gjithashtu edhe mishi i pjekur, patatet e fërguara dhe natyrisht edhe Pica.



Kjo është Maggie. Qenushja është e vëllait tim, por unë luaj shpesh me të ose dal me të e bëj shetitje. Unë kam edhe një peshk të lezetshëm. Kafshët i pëlqej shumë.



Në kohën e lirë shëtis me biçikletë. Në fotografi do të më shikoni në breg të liqenit „Açude Itamagi“, i cili është pak jashtë qytetit. Aty ku shikoni tani biçikletën time është plot me ujë në këtë kohë, pasi ka rënë shumë shi. Kur dëgjojnë se nga vij unë kujtojnë të gjithë një shkretëtirë, kaktena dhe pemë të thata. Por nuk është gjithnjë kështu! Ne kemi edhe stinën kur bien shumë shira dhe ku çdo gjë bëhet përsëri jeshil, pra, kur çdo gjë gjelbëron përsëri.



Unë kam shumë shokë. Por edhe me kushërinjtë e mi luaj me kënaqësi. Këtu jemi në token, në fushat e prindërve të mi. Ndonjëherë të korrat janë të mbara, kështu që kemi mjaftueshëm për familjen tonë dhe na mbetet diçka për të shitur.





Photo: ©Photographie.eu - stock.adobe.com

## | Fundi i jetës njerëzore

Mbrojtja dhe dhurimi i organeve, dëshira për fëmijë dhe ndihma në vdekje (eutanazia): Çështja e jetës dhe e vdekjes është diçka direkte dhe shumë personale. Në mënyrë që t'u japë besimtarëve një orientim për vendimin e tyre të pavarur, shkrimi zyrtar "Fillimi dhe Fundi i Jetës Njerëzore" ndriçon situatën nga këndvështrimi i besimit apostolik të ri.

Nga këndvështrimi i besimit tonë, njeriu është krijuar nga Zoti në shëmbëlltërinë e tij dhe është një pjesë e krijimit të dukshëm dhe të padukshëm. Natyra shpirtërore e njeriut është e pavdekshme. Trupi fillon me bashkimin e qelizave të vezës dhe spermës dhe mbaron me shuarjen e tij, me vdekjen.

Njohuritë biomjekësore kanë bërë të mundur ndërhyrjen në fillimin dhe në fundin e jetës njerëzore në një mënyrë kontrolluese që nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të. Meqenëse njeriu është krijuar si shëmbëlltëria e Zotit, ai është veçanërisht i denjë për mbrojtje, për këtë arsye lind pyetja për fillimin dhe mbarimin e saktë të jetës njerëzore në mënyrë që të mos biem ndesh me urdhëresën hyjnore. Nga këndvështrimi i besimit tonë është gjithashtu e rëndësishme kur jeta e njeriut animohet, krijohet dhe kur në procesin e vdekjes mendja dhe shpirti ndahen nga trupi. Kjo është e lidhur ngushtë me shpirtat që tashmë janë larguar nga kjo jetë.

## Përgjegjësia personale dhe orientimi

Për t'i dhënë besimtarëve orientim në vendimmarrjen e tyre të pavarur, metodat biomjekësore dhe mundësitë e ndërhyrjes në fillimin dhe në fundin e jetës njerëzore shqyrtohen nga këndvështrimi i besimit tonë.

Në mënyrë të veçantë, kur bëhet fjalë për metodat e kontraktivëve ose mbarësimin artificial, duhet të kihet parasysh nëse jeta e njeriut parandalohet të zhvillohet ose nëse ajo vritet. Në këtë kontekst, bëhet fjalë për përfundimin e jetës njerëzore edhe kur qelizat vezë të fekunduara artificialisht shkatërrohen ose embrionet që rriten në mitër abortohen. Në fushën e eutanazisë (ndihmesës për të vdekur) dhe heqjes së organeve nga njerëzit me tru të vdekur, është e rëndësishme që të mos ketë shkurtim aktiv, me qëllim të jetës apo edhe vrasje.

## Mendimi ynë për fillimin

Revista kishtarë "Community" trajtoi "fillimin e jetës njerëzore" në numrin e mëparshëm. Mendimi zyrtar i Kishës apostolike të re për këtë:

- Në mënyrë që të mbrojtë sa më mirë që të jetë e mundur njeriun si imazhin e Zotit, Kisha respekton jetën e njeriut që nga momenti i fekondimit dhe nuk pranon ta vrasë këtë jetë. Kjo jetë ka dinjitet të pakufizuar njerëzor.
- Se kur zhvillohet animacioni është në duart e Zotit dhe nuk mund të përcaktohet qartë nga pikëpamja

njerëzore. Sidoqoftë, për një mbrojtje sa më të madhe të mundshme të jetës njerëzore, Kisha supozon se krijimi, animimi bëhet në kohën e bashkimit të qelizave të spermës dhe vezës.

- Ajo pranon ato metoda biomjekësore dhe trajtime që nuk shkatërrojnë qëllimisht vezët e fekunduara (pa përzgjedhje njerëzore).
- Kisha e di që ekziston një përzgjedhje natyrore, biologjike, në të cilën një numër i konsiderueshëm i qelizave vezë të fekunduara (embrionet) vdesin pa ndërhyrjen e njeriut.
- Të vepruarit në përputhje me mendimet e kishës sonë mund të kufizojë atë që është e mundshme nga ana mjekësore. Këto kufizime duhet të pranohen me besim të Zotit, sepse jeta njerëzore është dhënë nga Zoti dhe duhet në thelb të respektohet.

## Procesi i vdekjes

Në fund të jetës njerëzore ekziston procesi i vdekjes që përfundon me vdekjen fizike. Në varësi të shkakut, ky proces i vdekjes mund të zgjasë shumë ose të çojë në vdekje të menjëhershme. Kur ndodh vdekja, jeta biologjike pushon dhe shpirti i pavdekshëm ndahet nga trupi.

Me mundësitë në rritje të mjekësisë intensive, pacientët në koma janë mbajtur artificialisht të gjallë apo në jetë që nga viti 1960. Tani ngrihet pyetja në një mënyrë të re dhe krejtësisht ndryshe, se kur ndodh saktësisht vdekja, sepse






Photo: ©freshidea - stock.adobe.com

ishte e nevojshme të përcaktoheshin nën cilat rrethana mund të përfundojnë përsëri masat e mbajtjes në jetë.

Disa njerëz, nga dashuria për tjetrin, edhe pas vdekjes së tyre duan të ndihmojnë të tjerët përmes dhurimit të organeve. Edhe këtu u bë i domosdoshëm një përkufizim i ri i vdekjes, sepse organet mund të hiqen vetëm pas vdekjes, por në rast dhurimi duhet të hiqen ndërsa ato janë akoma funksionale.

Për të lehtësuar dhimbjen gjatë procesit të vdekjes ose për të lehtësuar agoninë në kuptimin e një "vdekjeje të denjë", të afërmit dhe mjekët po mendojnë thellë për eutanazinë (ndihmesën në procesin e vdekjes). Në disa raste, mendime të tilla janë gjithashtu pjesë e së ardhmes, për shembull si pjesë e një lënie me shkrim nga ana e pacientit.

Për këto sfera, kërkohen sot vendime ligjore brenda kornizës së përcaktuar. Nga këndvështrimi i besimit tonë mbështeten sot vendime të tilla.

## Pikëpamja mjekësore

Procesi i vdekjes i paraprin vdekjes. Kjo nuk është një ngjarje e përpiktë, por një dështim gradual funksional i organeve deri në qelizat individuale. Për shembull, qelizat e indit lidhës mund të mbijetojnë me javë edhe pas vdekjes së trurit dhe pushimit të zemrës.

Truri është organi vendimtar i kontrollit të trupit. Pas vdekjes së tij, të gjitha organet dhe indet vdesin në mënyrë të pashmangshme. Vdekja e trurit zakonisht ndodh vetëm disa minuta pas një pushimi përfundimtar të zemrës.

Sot është e mundur të përcaktohet një dështim i plotë dhe i pakthyeshëm funksional i trurit, duke përfshirë të gjithë qelizat e trurit, në pacientët e mbajtur artificialisht në jetë, ndërsa aktiviteti i zemrës është akoma i pranishëm. Kjo ka çuar në faktin që, nga pikëpamja mjekësore, nuk është më vdekja kardiake por vdekja e trurit që përbën apo përcakton



kriterin për vdekjen. Në mënyrë që të kemi sigurinë më të madhe të mundshme kur përcaktohet vdekja e trurit, rezultatet e gjera të ekzaminimit duhet të konfirmohen në intervale të ndryshme kohore nga dy specialistë të pavarur.

Vdekja e trurit përcaktohet si funksioni i përgjithshëm i shuar në mënyrë të pakthyeshme të trurit të madh, trurit të vogël dhe gjithë qelizave të trurit. Funksioni kardiovaskular ruhet ende artificialisht përmes ventilimit të kontrolluar.

Koma me sy hapur duhet ndarë nga vdekja e trurit dhe duhet parë në përputhje me mbijetesën e gjatë. Bëhet fjalë për një çrregullim të zgjatur të qarkullimit të gjakut në tru, ku rrjedha e trurit është akoma funksionale. Pacientët mund t'i kenë sytë hapur por të mos fiksohen në asgjë. Të folurit dhe reagimi ndaj stimujve të jashtëm nuk është i mundur. Sidoqoftë, disa reflekse të tilla si reflekset e thithjes dhe kapjes janë të pranishme.

## Pikëpamja ligjore

Për shumë vende, nga pikëpamja ligjore, vdekja pranohet kur vdekja e trurit përcaktohet nga një vlerësim, një gjykim i përshkruar mjekësor.

## Pikëpamja fetare

Në lidhje me fundin e jetës, procesi i vdekjes dhe shoqërimi i vdekjes nga pastorët dhe të dashurit familjarë janë shumë më të rëndësishme për të gjitha fetë, sesa koha e saktë e vdekjes. Ekzistojnë gjithashtu rregullore në konfesionet ose fe të ndryshme për ndërmjetësimin dhe shlyerjen për të vdekurit në lidhje me vdekjen dhe dorëzimin e trupit.

Kur bëhet fjalë për mendimin mbi temat e dhurimit të organeve ose djegien e kufomave, idetë për jetën pas vdekjes luajnë një rol vendimtar.

Në besimin e krishterë, vdekja shpesh interpretohet si një tranzicion, kalim në botën e përtejme. Kriteri i vdekjes së trurit njihet nga kishat kryesore të krishtera dhe mbështetet edhe dhurimi i organeve. Nuk përcaktohet një kohë fikse se kur shpirti largohet nga trupi.

Pozicioni, mendimi i Kishës Apostolike të Re për fundin e jetës njerëzore

- Nuk mund të jepet një kohë e saktë se kur shpirti ndahet nga trupi. Nuk ka asnjë referencë për këtë në Bibël dhe as ka ndonjë metodë shkencore me të cilën mund të konstatohet kjo. Përveç kësaj, jeta dhe vdekja janë të ndërthurura, kështu që një përcaktim i rreptë i kohës në të cilën shpirti është i ndarë nga trupi duket arbitrar.
- Në mënyrë që të mbrojnë njeriun si imazhin e Zotit sa më mirë që të jetë e mundur, Kisha respekton plotësisht jetën njerëzore deri në vdekjen e trurit dhe hedh poshtë ndërhyrjet që sjellin në mënyrë aktive vdekjen.
- Kisha supozon se me vdekjen e trurit ka një ndarje të shpirtit nga trupi. Trajtimi dinjitoz i trupit të vdekur është një traditë e shumë feve dhe vlen gjithashtu edhe për situatat në të cilat frymëmarrja dhe qarkullimi mbahen artificialisht në jetë pas vdekjes së trurit, në mënyrë që të jenë në gjendje të heqin organet për një transplant.

## Përmbledhje

Koha e krijimit të një jetë dhe momenti kur shpirti e le trupin pas vdekjes, nuk mund të përcaktohen shumë prerë, shumë qartë. Për të mbrojtur jetën njerëzore, kisha mendon se, jeta fillon që me ngjizjen e vezës dhe mbaron apo përfundon me vdekjen përfundimtare të trurit. Ajo duhet mbrojtur dhe nuk duhet të mbarojë në mënyrë aktive.

Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrih/Zvicër

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Peter Johanning

# Ndryshime në rrethin e apostujve

Në rrethin e apostujve pati disa dalje në pension apo emërimë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2020 – për shkak të rregullave të Koronës pati kufizime në udhëtime, për këtë arsye vepruan apostujt e distrikteve të ngarkuar prej apostulit kryesor. 348 apostuj janë aktive në të gjithë botën.



Iart: Apostuli Lionel Meyer  
majtas: Apostuli Jonathan Karl Sturm dhe Apostui Arnaud Martig

Më 31 Dhjetor 2020 u numëruan 250.500 vëllezër administrate, të cilët janë aktivë në poste të ndryshme si diakonë apo prifta. Ata kujdesen së bashku me apostujt për 57.800 bashkësi vëllezërish e motrash në të gjithë botën. Në një shërbim aktiv janë aktualisht 325 Apostuj, 7 ndihmës-apostuj distriktesh, 15 apostuj distriktesh dhe një apostul kryesor.

## Emërimë

Apostuli i distriktit Mark Woll emëroi në postin e apostujve të dielën më, 20 Dhjetor 2020, bishopin Jonathan Karl Sturm (1976) për Kanadanë Perëndimore dhe evangelistin e distriktit Arnaud Martig (1971) për Kanadanë Qëndrore

dhe Lindore. Gjithashtu atyre iu dha përgjegjësia si apostuj udhëheqës edhe për Republikën e Kongos, Republikën Afrikane Qëndrore, Ruandën dhe Çadin.

## Dalje në pension

Apostuli i distriktit John Kriel nxori në pension, ditën e dielë, më 20 shtator 2020, apostulin Lionel Meyer (1955). Apostul Meyer ka qenë aktiv për dhjetë vjet në zonën e punës së apostulit të distriktit për Afrikën e Jugut. Kjo dalje në pension u bë në Barberton (Afrika e Jugut).

Të dielën, më 20 dhjetor 2020, apostuli i distriktit Mark Woll nxori në pension ndihmës-apostulin e distriktit John

Sobottka (1956). Mbi 17 vjet ka punuar ndihmës-apostuli i distriktit në Azi, Afrikë dhe Kanada. Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider do të kishte shkuar me kënaqësi personalisht, por nuk u lejua, për shkak të Pandemisë së Koronës, të udhëtonte në Kanada.

### Pushim/ heqje, largim nga detyra

Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider i dha apostul Baker Chakwana (Zambia) në Tetor pushim nga detyra për një vit për arsye familjare. Apostuli Gabin Mwemena (RD Kongo Juglindor) dha dorëheqje nga detyra në nëntor për arsye private. Drejtuesi i kishës internacionale e aprovoi këtë vendim.



Apostuli Gabin Mwemena

### Zonat e apostujve të distrikteve

Kisha Apostolike e Re në mbarë botën është e ndarë në 15 zona pune, distrikte. Këto distrikte drejtohen nga apostujt e distrikteve. Përgjegjës për keto janë apostujt e mëposhtëm:

- Michael David Deppner (1961) – RD Kongo Perëndimor
- Michael Ehrich (1959) – Gjermania e Jugut
- Joseph Opemba Ekhuya (1969) – Afrika Lindore
- Edy Isnugroho (1963) – Azia Juglindore
- Leonard Richard Kolb (1956) – USA
- Rüdiger Krause (1960) – Gjermania Veriore dhe Lindore
- John Leslie Kriel (1956) – Afrika e Jugut
- Enrique Eduardo Minio (1960) – Amerika e Jugut
- Wolfgang Nadolny (1956) – Berlin-Brandenburg
- Peter Schulte (1963) – Pacifiku Perëndimor
- Kububa Soko (1969) – Zambia, Malawi, Simbabwe
- Rainer Storck (1958) – Gjermania Perëndimore
- Tshitshi Tshisekedi (1972) – RD Kongo Juglindor
- Mark Woll (1959) – Kanada
- Jürg Zbinden (1958) – Zvcër

Disa nga apostujt e distrikteve ndihmohen apo mbështeten prej ndihmësave të tyre, të cilët janë aktive normalisht në vendet e zgjedhura, e ngarkuara për ta:

- David Devaraj (1959) – Indi
- Frank Stephan Dzur (1959) – Kanada
- John William Fendt (1957) – USA
- Arnold Ndakondwa Mhango (1957) – Malawi
- João Uanuque Misselo (1965) – Angola
- Mandla Patrick Mkhwanazi (1963) – Afrika e Jugut
- Robert Nsamba (1962) – Zambia



Iart: Ndhmës-apostuli i distriktit John Sobottka  
djathtas: Apostuli Baker Chakwana





**Krishti – e ardhmja jonë**

*„Le të rendim me durim  
në udhën që është përpara  
nesh, duke i drejtuar  
sytë te Jezusi, kreu dhe  
plotësonjësi i besimit“*

*Hebr 12,1b.2a*

**New Apostolic Church**  
International

